



01 Nr./Br. 011/01-8188
Data/Datum 31.03.2022

Kuvendi i Komunës- Gjakovë

01 Nr. /2022

Datë: 30.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit,12 dhe 17 shkronja **b)** të Ligjit nr. 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 14 shkronja **a)** të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2022, pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Ndryshimin e vendimit 01nr.011/01-3512 dt. 10.02.2022, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 2 e vendimit 01nr.011/01-3512 dt. 10.02.2022, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale.
2. Vendimi si në pikën 1 ndryshohet si në vijim: Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – parkingu do të jetë afatshkurtër, prej një (1) viti.
3. Pjesa tjetër e vendimit 01nr.011/01-3512 dt. 10.02.2022, për dhënien në shfrytëzim pronës së paluajtshme komunale parkingun mbetet në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
5. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Arbëneshë Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës